

AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“Hybrid Center” SHPK

Me date ~~28.06~~ 2024, themeluesi i meposhtem:

Agim Bedo, i biri i Jorgo, lindur me date 18.04.1964 ne Gjirokaster dhe banues ne Tirane, madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, identifikuar nga leternjoftimi me Nr. Personal G40418075R.

Ka vendosur krijimin e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar dhe nenshkruan Aktin e Themelimit te meposhtem te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar, aktiviteti i se ciles rregullohet nga legjislacioni shqiptar, nga percaktimet ne kete akt themelimi dhe nga statuti i saj, i cili eshte pjese perberese e ketij akti.

KREUI I

Neni 1

Krijimi

Shoqeria " **Hybrid Center**" SHPK, eshte person juridik i se drejtes shqiptare. Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, me poshte e quajtur "Shoqeria".

Neni 2

Personaliteti juridik

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi te jete regjistruar ne QKB, ne perputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj. Shoqeria, pasi te kete fituar personalitetin juridik, eshte pergjegjese ndaj te treteve per detyrimet dhe demet e shkaktuara gjate veprimtarise se saj.

Neni 3

Selia

Shoqeria e ka seline ne: Tirane Kashar KASHAR Autostrada Tirane-Durres, km 11, Godina "Hybrid".

Neni 4

Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te papercaktuar duke filluar nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit.

Neni 5

Objekti i veprimtarise

Shoqeria do te kete si objekt te veprimtarise:

Qender Tregtare. Menaxhim Qender Tregtare. Dhenie ambjentesh me qira.

Shoqeria mund te bashkepunoje edhe me shoqeri te tjera me objekt te njejte ose te ndryshem nga i saj.

Shoqeria ka te drejte te shtoje objektin e veprimtarise se saj, ne çdo kohe sipas ligjeve ne fuqi.

KREU II

KAPITALI

Neni 6

Kapitali themeltar



1. Kapitali themeltar i shoqerise eshte **100,000 (Njeqind mije) leke**, i perbere nga nje kuote e vetme me vlere te pergjithshme **100,000 (Njeqind mije) leke**, e cila perben **100%** te kapitalit themeltar te shoqerise.
2. *Ortaku themelues i Shoqerise "Hybrid Center" SHPK, Z. Agim Bedo eshte zoteruesi i 1 (nje) kuote me vlere 100,000 (Njeqind mije) leke. e cila perben 100% te kapitalit themeltar te shoqerise.*

Neni 7

Transferimi i kapitalit

1. Pjeset e kapitalit themeltar mund t'u transferohen personave te trete qe nuk bejne pjese ne shoqeri, vetem me miratimin e Ortakut te vetem.
2. Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie. Ato jane te transferueshme edhe ne rast ndarjeje pasurore mes bashkeshorteve. Gjithashtu jane te transferueshme ndermjet bashkeshorteve si dhe ndermjet paraardhesve dhe pasardhesve. nepermjet akteve ligjore.

KREU III

ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimmarres

1. Asambleja e Pergjithshme eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e meposhtme:
 - a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
 - b) ndryshimet e statutit;
 - c) emerimin e shkarkimin e administratorit/ve;
 - d) emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
 - e) percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat "c" dhe "d" te kesaj pike;
 - f) mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
 - g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
 - h) zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
 - i) pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - j) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
 - k) riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
 - l) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;
 - m) ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.
2. Asambleja e Pergjithshme merr vendime per ceshtjet e percaktuara ne shkronjat "e" dhe "f" te pikes 1 te ketij neni, pas marrjes dhe shqyrtimit te dokumenteve perkates.
3. Te drejtat dhe detyrimet e asamblese se pergjithshme ushtrohen nga Ortaku i vetem. Te gjitha vendimet e marra nga Ortaku i vetem regjistrohen ne nje regjister te vendimeve, te dhenat e te cilit nuk mund te ndryshohen ose te fshihen. Duhet regjistruar ne veçanti, por pa u kufizuar ne to, vendimet per:
 - miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
 - shperndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
 - investime;
 - vendimet per riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Vendimet e paregjistruara ne regjistrin e vendimeve jane absolutisht te pavlefshme. Shoqeria nuk mund t'i kundrejtoje pavlefshmerine te tretit, qe ka fituar te drejta ne mirebesim, perveç rastit kur shoqeria provon



se i treti ka pasur dijeni per pavlefshmerine, apo ne baze te rrethanave te qarta nuk mund te mos kishte pasur dijeni per te.

4. Ortaku i vetem mund te perfaqesohet edhe nga nje tjeter person, nepermjet prokures.
5. Mbledhja e zakonshme e asamblese se pergjithshme thirret te pakten nje here ne vit.

Neni 9 **Ndryshimet e Statutit**

Ndryshimet e statutit vendosen nga Ortaku i vetem.

Çdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane Qendres Kombetare te Biznesit per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Neni 10 **Administrimi**

Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te Ortakut te vetem te shoqerise.

Ortaku i vetem vendos per sistemin e administrimit, dhe ne rastin e nje organi administrativ me shume administratore, percakton numrin e tyre dhe kompetencat.

Administratori/ret, mund te jene ose jo ortake te shoqerise.

Administratori mund te shkarkohet ne çdo kohe.

Administrator i shoqerise eshte Z. **Agim Bedo**, njekohesisht dhe ortaku i vetem i saj.


Administratori i shoqerise do te ushtroje kompetencat e tij ne kete detyre per nje periudhe **pese vjeçare**, sipas ligjit.

Neni 11 **Kompetencat e Administratorit**

Shoqeria administrohet nga nje Administrator i vetem.

Administratori ka te drejte e detyrohet te:

- a) Kryeje te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga asambleja e pergjithshme;
- b) Kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqerise;
- c) Pergatit dhe nenshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraqet keto dokumente perpara asamblese se pergjithshme per miratim;
- d) Krijoje nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise;
- e) Kryen regjistrimet dhe dergon te dhenat e detyrueshme te shoqerise, siç parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit;
- f) Raportoje perpara asamblese se pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posaçme me rendesi te veçante per veprimtarine e shoqerise tregtare;
- g) Administratori ka te drejte te kryeje te gjitha veprimet e administrimit te zakonshem e te Jashtezakonshem;
- h) Administratori perfaqeson shoqerine perpara te gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo te huaj, autoriteteve shteterore Shqiptare apo te huaja, perfshi ketu autoritetet gjyqesore te te gjitha shkalleve;



- i) Administratori ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne marredhenie me te tretet ne emer te shoqerise, ne te gjitha rrethanat me perjashtim te kompetencave qe ligji ia jep shprehimisht ortakeve te shoqerise;
- j) Administratori angazhon shoqerine ne marredheniet me te tretet nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e saj;
- k) Administratori ka gjithashtu te drejte te nenshkruaje kontrata te ndryshme ne emer e per llogari te Shoqerise, perfshire ketu kontratat e qirase, shitjes, blerjes, kredive a hipotekimit te pasurive te paluajtshme, te nenshkruaje aktet e themelimit te shoqerive te tjera ku Shoqeria eshte ortak;
- l) Te nenshkruaje e hartoje çdo dokument e te kryeje ne emer te Shoqerise çdo veprim perballe te gjitha Bankave shqiptare apo te huaja ne lidhje me çeljen apo mbylljen e llogarive rrjedhese te Shoqerise, nenshkrimi i kontratave te ndryshme bankare per financimin e Shoqerise si dhe te kryeje veprime terheqje e derdhje shumash nga keto llogari pa limit, administrimin e kartave te debitit, kreditit dhe çeqeve ne emer te shoqerise;
- m) Administratori ka gjithashtu te drejte te kryeje ne platformat online (e-banking) gjithë shërbimet qe keto platforma ofrojne;
- n) Shoqeria nuk merr persiper pasojat ndaj te treteve kur ajo provon se te tretet e dinin qe akti i administratorit e kalonte objektin e shoqerise ose kur te tretet nuk mund ta injoronin kete akt ne rrethanat e dhena, duke pasur parasysh faktin se vetem shpallja e statutit nuk eshte prove e mjaftueshme;
- o) Klauzolat e ketij statuti qe kufizojne kompetencat e administratorit, te cilat rrjedhin nga ky nen, duhet te respektohen nga te tretet;
- p) Administratorit ose ortakut qe nuk eshte person juridik, nuk u lejohet te kontraktojne ne çfaredolloj forme qofte, te marrin hua te shoqeria, te japin pelqimin ne emer te saj, per paradhenie si dhe te behen dorezenes apo te garantojne ne emer te saj angazhimet ndaj te treteve. Ne rast te kundert kontrata eshte e pavlefshme;
- q) Administratori ka te drejte te transferoje tagrat e tij ne perputhje me Statutin e Shoqerise dhe Ligjin Nr.9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" tek person te trete me procure;
- r) Administratori ka te drejte te autorizojte tagrat e tij ne perputhje me Statutin e Shoqerise dhe Ligjin Nr.9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" tek person te trete me prokure;


Neni 12
Viti Financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor.
Perjashtimisht viti i pare- financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise prane Qendres Kombetare te Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 13
Shperndarja ose prishja e shoqerise

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne çdo kohe dhe per çfaredo shkak, edhe para plotesimit te afatit per te cilin eshte krijuar siç mund te jene :

- a) Humbja e kapitalit ose pamundesia e vazhdimit te metejshem te veprimtarise se saj;
- b) Ne nje nga menytrat e parashikuara nga ligji " Per Falimentimin e Shoqerive Tregtare"
- c) Kur plotesohet afati i caktuar per ushtrimin e veprimtarise tregtare.



Ne kete rast Ortaku i vetem merr vendim me shkrim ne te cilin parashikon menyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne çdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese " Shoqeri ne likuidim e siper " .

Neni 14
Baza Ligjore


Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete akt themelimi, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republikën e Shqiperise qe ka lidhje me objektin e veprimtarise se shoqerise.

Neni 15
Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u hartua ne 4 ekzemplare me permbajtje dhe vlera te njejta juridike, dhe pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaku themelues i shoqerise tregtare "**Hybrid Center**" **SHPK**, nenshkruhet rregullisht.

ORTAKU THEMELUES
Z. AGIM BEDO

A handwritten signature in blue ink, reading "Agim Bedo", is written over a horizontal line. The signature is cursive and extends to the right of the line.